

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, Tonka Berishaj dhe Have Haliti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional, Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve: V.H., për shkak të veprave penale –mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPRK-së dhe veprës penale –lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së, V.J., për shkak të veprave penale –lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së dhe veprës penale –mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPRK-së dhe B.H., për shkak të veprës penale –kanosja nga neni 185 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit V.H., av. F.A. e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.165/2018 të datës 14.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.10.2018 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.H., av. F.A., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.165/2018 i datës 14.09.2018 vërtetohet.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan të akuzuarit V.H. dhe V.J. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së. Të akuzuarit V.H. dhe V.J. i ka shpallur fajtor edhe për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse të akuzuarin B.H. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Të akuzuarit V.H. për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) €, kurse për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, ashtu që të akuzuarit V1. në kuptim të nenit 80 par.1 dhe 2 nën par.2.4 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumën prej 900 (nëntëqind) €. Të akuzuarit, koha e kaluar në paraburgim nga data 29.07.2018 e deri me 28.08.2018 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë. Pjesën e mbetur të dënimit me gjobë në shumën prej 300 (treqind) €, i akuzuari është detyruar që ta arkëtojë në afatin prej 3 (tre) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit V.J. për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind)€, kurse për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 300 (treqind) €, ashtu që në kuptim të nenit 80 par. 1 dhe 2 nën par.2.4 të KPRK-së të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumën prej 900 (nëntëqind) euro. Të akuzuarit, koha e kaluar në paraburgim nga data 29.07.2018 e deri me 28.08.2018 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë. Pjesën e mbetur të dënimit me gjobë në shumën prej 300 (treqind) € i akuzuari është detyruar që ta arkëtojë në afatin prej 3 (tre) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit B.H. për veprën penale kanosje nga neni 185 par.1 i KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) € të cilën gjobë i pandehuri detyrohet që ta arkëtojë në afatin prej 3 (tre) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund ta bëjnë pagesën e gjobës, atëherë gjykata të njëjtëve dënimet me gjobë do t'iu zëvendësoj në dënim me burg, ashtu që për çdo 20 (njëzet) € gjobë, do tu llogaritet me një ditë burgim.

Detyrohen të pandehurit, që secili prej tyre veç e veç të paguajnë shpenzimet e procedurës penale, përkatësisht paushallët gjyqësore në shumën prej nga 20 € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të akuzuarve V.H. dhe V.J. gjykata iu shqipton edhe dënimet plotësuese, konfiskimin e armëve të ftohta-thikat të sekuestruara nga ana e Policisë së Kosovës, të përshkruar si në dispozitivët IV dhe VI të aktakuzës.

I dëmtuari S.S. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-Mbrojtësi i të akuzuarit V.H., av. F.A. për shkak të vendimit mbi sanksionin penal më propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar vetëm sa i përket vendimit mbi sanksionin penal ashtu që të akuzuarit V.H. për veprat penale të kryera ti shqiptojë dënim më të ulët me gjobë.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/I nr. 462/18 të dt. 08.10.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit V.H., av. F.A. ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK, për shkak se kemi të bëjmë me aktgjykimin e ankimuar në të cilin të akuzuarit janë dënuar me gjobë, gjykata nuk e ka parë të arsyeshme që të mbahet seancë gjyqësore, e për këtë palët nuk janë njoftuar për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësi të akuzuarit së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar prishjen e tij.

Po ashtu gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që nuk lejohet ankesa për këtë bazë ankimore sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, meqë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe me këtë është pajtuar prokurori si dhe trupi gjykues, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve tjera ankimore.

Vendimi mbi dënimin

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit, nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së si dhe nenin 75 dhe 76 të KPRK-së lidhur me mundësinë e zbutjes së dënimit, duke konsideruar se dënimi me gjobë i shqiptuar ndaj të akuzuarit V.H., nuk është adekuat dhe në proporcion me përgjegjësinë penale të akuzuarit. Po ashtu thekson se duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cilat janë konstatuar në anën e këtij të akuzuari si: pranimin e fajësisë për veprat penale që i vihen në barrë, moshën e re, sjelljen e tij korrekte në gjykatore, pendimin për kryerjen e veprave penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të tjera, gjendjen e varfër pasurore si dhe faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar, gjykata e shkallës së dytë duhet ti ketë parasysh ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj një dënim më të ulët me gjobë, e me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të akuzuarve, i ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në bazë të neneve 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë për bazë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprat penale që iu vihen në barrë, se të njëjtit janë penduar dhe i kanë premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të këtilla apo të ngjashme penale ashtu që në bazë të dispozitave edhe iu ka shqiptuar dënimin me gjobë. Vlerësimin e këtillë të rrethanave për matjen e dënimit, si të drejtë e aprovon edhe Gjykata e Apelit, e cila vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit dhe me të cilin është pajtuar edhe Prokurori, është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe është në funksion të preventivës së

përgjithshme posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPPK-së. Për një dënim më të ulët, siç pretendon mbrojtja nuk janë plotësuar kushtet ligjore, aq më parë kur në ankesë nuk theksohen rrethana të tilla të cilat do të arsyetonin një dënim më të ulët.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**PAKR 486/2018 datë 16.10.2018**

**Procesmbajtës,**

Eroll Gashi

**Anëtarët e kolegjit,**

Tonka Berishaj

\_\_\_\_\_  
Have Haliti

**Kryetari i kolegjit,**

Fillim Skoro